Mal BERISHA

# NJE EPISOD NË KUJTIM TË REGJISORIT TË MADH PIRRO MANI

# Mal BERISHA

## NJE EPISOD NË KUJTIM TË REGJISORIT TË MADH PIRRO MANI

**Piro Mani nuk është më!**

Sot, bota artistike shqiptare – dhe jo vetëm – është në zi për humbjen e njërit prej figurave më të mëdha dhe më emblematike të teatrit dhe kinematografisë: Mjeshtrit të Madh, Artistit të Popullit, Pirro Mani.

Jam shumë i sigurt se miqtë e tij të afërt kanë mijëra kujtime të natyrave të ndryshme. Edhe unë kam një të tillë.

Në vitet ’80 të shekullit të kaluar kam pasur fatin të kem miqësi me artistët e mëdhenj, Pirro Mani dhe Kadri Roshi. Me ta më lidhte një dashuri dhe respekt që shkonte përtej jetës së tyre profesionale, aq të shquar dhe të dashur për artdashësit e asaj kohe.

Ishin edhe detaje të jetës, si ky që do të tregoj më poshtë, që na e bënin jetën të begatë, përkundër privacioneve të kohës.

Pasioni i këtyre artistëve për teatrin shoqërohej edhe me një pasion tjetër – peshkimin. Ata ishin prej atyre njerëzve që prisnin me durim të pafund, derisa një caragë t’u binte në grep.

Një herë, kur punoja në Pallatin e Kulturës në Laç, erdhën Kadri Roshi, bashkë me Pirro Manin. Pirroja ngiste një motor “Java”. Të dy ishin veshur me rroba peshkatarësh dhe kishin me vete trastat, kallamat, fillspanjat dhe grepat. I prita, si gjithmonë, me respekt. Pimë kafe në katin e parë të Pallatit

të Kulturës, ku na shërbente Teto Evanthia. Tërë salla u ngrit t'i qeraste dhe t'i përshëndeste ata artistë që i donin aq shumë.

Pasi dolën, Kadriu më tha:
— Mal, a do të më bësh një nder? Nuk e di se si do të na shkojë peshkimi sonte dhe sa kohë do të rrimë në bregdet, në Patok. Por, po e pamë keq, mbase kthehemi — por nuk duam të udhëtojmë natën për në Tiranë.
Sikur të na lije një çelës të pallatit dhe ndonjë dhomë aktorësh, që të vimë, të pushojmë pak dhe pastaj në mëngjes të ikim?!

Pa një, pa dy, ua dhashë çelësat e pallatit dhe të dy dhomave, në katin e parë.
Ata kishin zënë diku dy a tre kilogramë peshk dhe ishin kthyer rreth mesnatës. Kishin hyrë secili në dhomën e vet. Kadriu e kishte varur peshkun që të mos prishej, në dritare, e cila ishte e hapur.
Mesa duket, dikush që kalonte atypari e kishte parë tek po e varte peshkun në dritare, në një kabllo telefoni që kalonte aty, dhe kishte pritur sa të fikej drita.
Pas pak, kalimtari i rastit ishte kapur në zuglaturën e dritares, e kishte tërhequr kabllon, e kishte këputur dhe e kishte marrë peshkun me vete.

Kadriu, i cili ende ishte zgjuar, kishte dalë në dritare dhe kishte bërtitur:
— Na more, i paudhë! Ç'deshe me peshkun? Ej, se mos bie në korent! Të lutem, ktheje peshkun! Kujdes, do të vdesësh nga korenti! Na moreee!

Por njeriu, në anën tjetër të xhamit, kishte dalë në lulishten që ishte përballë dritares dhe qeshte. Pastaj kishte ikur... bashkë me peshkun!

Në mëngjes shkova në punë. Menjëherë më ra në sy motori i Pirro Manit.
*"Epo," – thashë, – "këta paskan ardhur dhe kushedi sa peshk do të kenë zënë!"*
Ngjita shkallët dhe i vura re që të dy, në tavolinën e parë pranë derës – të dy kokëulur.
Në kokë mbanin nga një kapele ushtarake me strehë, pa yll. Nuk fliste asnjëri, as tjetri.

I përshëndeta dhe i pyeta se si ju kishte shkuar peshkimi. Pirroja më tha:
— Pyete Kadriun, se ai e di si shkoi.

— Hë, profesor, – thashë, – si vajtët?

— Lëre, – më tha. – Mos më pyet. U dreqos puna fare.

Dhe më tregoi se si kishte ndodhur me njeriun që ua kishte marrë peshkun.

— Tani do ikim, – më tha. – Po kush i del përpara Agim Qirjaqit! I kemi thënë që të na priste sot në drekë, se do sillnim peshk dhe do të shkonim te një lokal i yni i preferuar, që ta gatuanim atje.
Tani nuk kemi gjë në dorë. *Puff!*E mori djalli. Ku u gjet ai njeri që na la me duar bosh!?”

— Aman, – më tha Profesori Kadri, – se mos i thua ndokujt që na gjeti kjo hata, se do qeshë bota me ne!

— Jo, ore, ç’ne, – i thashë unë. – Po kujt do t’ia them unë, tek e fundit!

— He pra, se neve po ikim!

Ia hipën motorit dhe u nisën për Tiranë.
Kur vajtën në Teatër, në Tiranë, këta “peshkatarë” po i prisnin krahëhapur artistët e tjerë.

Kuptohet zhgënjimi i të gjitha palëve. Kjo nuk është si ato rrëfimet e ekzagjeruara të peshkatarëve por një ngjarje e vërtetë e mbushur plot me humor. Pas asaj ngjarje, sa herë që ata shkonin për peshkim, në teatër qeshnin dhe thoshnin:

Bëhuni gati, se po vijnë Pirro me Kadriun, plot me peshk nga Laçi!
Njerëz me botë të madhe dhe me humor në jetën e tyre, aq sa meritojnë solemnitet dhe respekt, meritojnë edhe kujtime

të bukura, që mbushnin jetën e tyre dhe të njerëzve të thjeshtë që i rrethonin.

Nderim për Pirro Manin, njeriun që i dha formë ndërgjegjes sonë estetike në fushën e artit dramatik!
I qoftë i lehtë dheu!